



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE  
NJERËZORE  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT, KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT**

**RELACION**

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËRRIDHËNIEN ME QIRA, TË TRUALLIT ME  
SIPËRFAQE 205 M2, PJSË E PASURISË NR.2/353 ZK 8563M, PËR QËLLIME  
BIZNESI”**

Bashkia Korçë është pronare e pasurisë nr.2/353 ZK 8563, me vendndodhje në Lagjia 14, Rr.Partizani, Korçë. Ky truall i ka kaluar në pronësi Bashkisë Korçë, bazuar në VKM-në 1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë”.

Bashkia Korçë, me qëllim realizimin e funksioneve të saj në fushën e zhvillimit ekonomik vendor, propozon fillimin e procedurave të ridhënies me qira të sipërfaqes 205 m2, pjesë e pasurisë nr.2/353 ZK 8563 për qëllime biznesi.

Me qëllim vazhdimin e shfrytëzimit të këtij objekti në pronësi publike të Bashkisë Korçë, dhe me misionin e një menaxhimi sa më eficient të aseteve të saj, i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për ridhënien me qira të kësaj pasurie.

Në referim të Kreut III të VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, propozojmë qëtarifa e qirasë mujore për truallintë jetë100 lekë / m2 / muaj.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) “njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë .... ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj” dhe c) “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës” dhe pika 1.6 gërma a) “e drejta e lidhjes së kontratës”si dhe germa e/1”...miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private” të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” e ndryshuar.

Bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014” i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë fillimin e procedurave për ridhënien me qira të truallit me sipërfaqe totale prej 205 m2, pjesë e pasurisë me nr.2/353

**zk 8563, në Rruga Partizani, Lagjia 14 për një afat 1 (një) vjeçar, me tarifën prej 100 lekë/m2, sipas genplanit bashkangjitur.**

**Drejtores e Përgjithshme**

**ANXHELA DISHNICA QERAMIXHIZHANETA LUBONJA**

**Drejtores e DPKZHT**

**KRYETARI**

**SOTIRAQ FILO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**  
**KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

**P/V E N D I M**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ 2023

**‘PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RIDHËNIEN ME QIRA, TË TRUALLIT  
ME SIPËRFAQE 205 M2, PJESË E PASURISË NR.2/353 ZK 8563M, PËR QËLLIME  
BIZNESI’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 54 gërma e/1 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”, si dhe në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë fillimin e procedurave për ridhënie me qira të truallit 205 m2, pjesë e pasurisë nr.2/353 ZK 8563 me vendndodhje në Rruga Partizani, Lagjia 14, Korçë për një afat 1 (një) vjeçar, me tarifën 100 lekë/m2, sipas genplanit bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

**Eva NAÇI**  
**ANA VERUSHI**

Miratuar me \_\_\_\_\_ vota

Vota Pro \_\_\_\_\_

Vota Kundër \_\_\_\_\_

Vota Abstenim \_\_\_\_\_

Zbardhur më datë \_\_\_\_\_